

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 20940126

Nr. i fq. / Br. st. - 2 -

Data: / Datum: 21.05.2026

VUSHTPRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 87/26, 21.05/2026

PROCESVERBAL

nga mbledhja konstituive e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 28 prill 2026 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 13:15.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Stefan Markoviç (kryesues), Behar Duraku, Gresa Muli, Fakete Dushi, Diellza Pllana, Miljan Bojkoviç, Berat Maloku, Florije Ramadani (Me vendim të kuvendit është bërë përmirësimi i gabimit teknik nga Fahrije Burgazi në Florije Ramadani) dhe Bekim Çuni, anëtarë të komitetit.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Melihate Basholli Latifi, kryesuese e kuvendit, Branislav Vuksanovic, udhëheqës i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Ekrem Merovci, koordinator për kthim dhe riatdhesim, Aktere Dërvari, përkthyes, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it slloven si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli Latifi, kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se ekziston shumica për punë dhe e hapi debatin për rendin e ditës. Ajo tha se ky është takimi i parë i komitetit, të cilin do ta udhëheq unë, derisa të zgjedhet kryesuesi/kryesuesja.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Zgjedhja e kryesuesit/kryesueses të Komitetit për Komunitete;
2. Të ndryshme.

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Komunitete.

Melihate Basholli Latifi, kryesuese e kuvendit - Ajo kërkoi nga anëtarët që t'i japin propozimet e tyre për kryesues/kryesuese të komitetit.

Miljan Bojkoviç, anëtar i komitetit- propozoi që kryesues i komitetit të jetë Stefan Markoviç.

Gresa Muli, anëtare e komitetit - propozoi që kryesues i komitetit të jetë Berat Maloku.

Branislav Vuksanoviç, udhëheqës i Zyrës për Komunitete dhe Kthim – fillimisht dua të ju përsërisht dhe t'ju përgëzoj për mandatin tuaj. Në mandatin e kaluar patëm një bashkëpunim të mirë me anëtarët e Komitetit të Komuniteteve. Shpresoj se edhe në këtë mandat do kemi një bashkëpunim të mirë dhe të sinqertë.

Ajo në të cilën do të doja të diskutoja është zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Komunitete. Besoj se kjo pozitë duhet t'i përket komitetit të parë joshumicë, të përfaqësuar në Komunën e Vushtrisë. Ai kërkoi nga anëtarët, nëse mund ta mbështesin dikë nga komuniteti serb, i cili është i vetmi i përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Vushtrisë.

Behar Duraku, anëtar i komitetit- pasi që kemi dy propozime për kryesues, ai kërkoi që të shkohet në votim të fshehtë.

Komiteti për Komunitete me tetë (8)vota “për” dhe një (1) “kundër” vendosi që të shkohet në votim të fshehtë për zgjedhjen e kryesuesit të Komitetit për Komunitete.

Pas votimit të fshehtë, rezultati ishte si në vijim:

- *Stefan Markoviç mori gjashtë (6) vota*
- *Berat Maloku mori tri (3) vota.*

Komiteti për Komunitete, pas votimit të fshehtë vendosi që Stefan Markoviç të jetë kryesues i këtij komiteti.

Stefan Markoviç, kryesues i komitetit- i falënderoi anëtarët e komitetit që ia besuan detyrën që të jetë kryesues i këtij komiteti.

2. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në ora 13:40.

Bujar Klinaku

Procesmbajtës



Stefan Markoviç

Kryesues i K. për Komunitete